



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Për miratim fondi per Ndermarrjen e Sherbimeve Publike

Nr 34 Datë 04-05.2010

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Ndermarrja e Sherbimeve Publike, "Për kalim fondi per Ndermarrjen e Sherbimeve Publike" Në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 10190 dt. 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", Udhëzimit nr 1 dt. 21.01.2010 te M.F. "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2010, Ligji 9936 date 26.06 2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise"si dhe V.K.B. nr. 20 dt. 25.03.2010 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010", mbeshtetur ne kompetencat qe ka dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Te miratoje kalimin e fondit prej 800 000 lekë, për Ndermarrjen e Sherbimeve Publike. i cili do te detajohet si me poshte:

Me propozim te keshilltareve u vendos qe:

Fondi per lulet	nga 400 000 Lek behet 450 000 Lek
Fondi per korniza hekuri	nga 200 000 Lek behet 250 000 Lek
Fondi per promocion	nga 200 000 Lek behet 100 000 Lek

2. Fondi do të përballohet nga fondet rezervë të bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00 04980 05 art	609 0000	- 800 000
Shtohet	00 06260 05 art	602 0000	+ 800 000 (NSHP)

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Ndermarrja e Sherbimeve Publike dhe Drejtoria e Finances
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Kryetari

Gjergji PENDAVINJI